



AA.nr.47/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Sahadije Mejzinolli, nga fshati Shalë Komuna e Lipjanit, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktvendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.966/2015 të datës 23.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses Sahadije Mejzinolli, nga fshati Shalë Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.966/2015 i datës 23.12.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.966/2015 të datës 23.12.2016, është refuzuar si e pabazuar, kërkesëpadia e paditëses Sahadije Mejzinolli, nga fshati Shalë Komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë nr.prot.290 të datës 17.04.2015.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja Sahadije Mejzinolli, për shkak të: shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 2 të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sipas dispozitave të nenit 184 të LPK-së. Me propozim që të miratohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.966/2015 të datës 23.12.2016, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses për përfitimin e ndihmës sociale, me të cilën ka kërkuar të



anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes në Prishtinë nr.prot.290 i datës 17.04.2015. Me aktvendimin e lartcekur, ankueses iu ka refuzuar ankesa si e pabazuar, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi nr.13-05360 i datës 13.03.2015, lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Lipjan. Me aktvendimin e lenë në fuqi i ndërprehet e drejta në ndihmë sociale, me arsyetim se bazuar në paragrafin 8.3 të nenit 8 të Ligjit për Skemën Sociale nr.2003/15, bazuar në regjistrin e DNS-së se njëjti ekziston në skemën e pensioneve kontributdhënëse e që me Ligjin e Skemës për Ndhimë Sociale (plotësim ndryshimin e tij) si dhe aktet tjera nënligjore ky pension është llogaritshëm, andaj bazuar në këto të dhëna iu është ndërprerë asistenca sociale.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka konkluduar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Kjo nga shkaku se komisioni për ankesa pas shqyrtimit të gjitha fakteve relevante dhe sipas dokumentacionit në lëndës ka konstatuar se bashkëshorti i paditëses Ruzhdi Mejzinolli realizon pension nga Skema e Pensioneve kontributive që sipas Ligjit për Skemën e Ndhimës Sociale nr.2003/15 dhe sipas Udhëzimit Administrativ nr.06/2013 ky pension është e hyrë financiare e llogaritshme, andaj, familja nuk përzgjidhet dhe nuk i njihet e drejta për vazhdimin e realizimit të ndihmës sociale. Prandaj, nuk mund ti pranohet e drejta për ndihmë sociale sepse do të ishte në kundërshtim me nenin 4.1 a) neni 5 par.5.7 të Ligjit mbi Skemën e Ndhimës Sociale nr.2003/15, si dhe nenit 5 par.5.3 të Ligjit nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për Skemën e Ndhimës Sociale në Kosovës, si dhe nenit 10 par.1.6 si dhe neni 12 e shtojcë e Udhëzimit Administrativ nr.06/2013 për përlllogaritjen e të mirave materiale dhe jo materiale si dhe të hyrave të llogaritshme dhe jo të llogaritshme.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare. Ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Duke pasur parasysh se në rastin konkret, aktvendimi i kontestuar është nxjerr pas shqyrtimit të gjitha fakteve relevante dhe dokumentacionit në lëndë, shihet së drejtë është zbatuar Ligji mbi Skemën e Ndhimës Sociale nr.2003/15, se paditësja me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e saj. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore, për shkelje thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 2 të LPK-së, se dispozitivi i aktgjykimi është kundërthënë me arsyetimin se nuk përshkruhen se cilat ishin faktet vendimtare, ky pretendim nuk qëndron. Ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsyet e nevojshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditëses, por gjeti se ato nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative. Prandaj gjykata e shkallës së parë me provat e administruara, drejt ka vepruar kur e ka refuzuar padinë e paditëses si të pabazuar.



Meqë ankuesja me pretendime të tjera ankimore nuk e ka vu në dyshim çështjen e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë. Ngase nuk ka argumentuar me asnjë provë se aktvendimi i kontestuar i të paditurës është jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj. Prandaj kjo gjykatë në tërësi i ka pranuar si të drejta arsyet juridike me të cilën është udhëhequr gjykata e shkallës së parë gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të kundërshtuar.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.47/2017, me datë 16.02.2017



Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi